

Data 18.09.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Blerje lende djegese per ngrohje (pellet) per nevoja te Spitalit Rajonal Diber - Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 1 vjeçar (12 muaj).

REF : 80383-09-18-2023

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

09110000-3- Lende ngrohese te ngurta

VLERA E FONDIT LIMIT:

15.000.000 (Pesëmbëdhjetë miliona) leke pa tvsh

- Ne perlllogaritjen e fondit limit eshte zbatuar VKM nr . 807 date 16.11.2022 neni 3, pika ç)
- Ne hartimin e DST eshte marre parasysh Vendimi nr. 10 date 05.10.2022 per hartimin e Dokumentave Standarte te tenderit _Procedure e Hapur , mallra , te APP.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor ***Drejtoria e Spitalit Rajonal Diber*** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim nga organet tatimore, për xhiron mesatare vjetore gjatë tre viteve të fundit, e cila të jetë jo më e vogël se **40%** të fondit limit/vlerës së pritshme të kontratave .

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 55, pika 4, "Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave". Referuar parashikimeve ligjore të nenit 43, pika 2, germa c), për procedurat nën kufirin e ulët monetar, siç është rasti i kësaj procedure. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në VKM "Për rregullat e prokurimit publik", e cila paashikon se Autoriteti koonraktor për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike mund të kërkojë për një periudhë maksimumi deri në 3 vitet e fundit financiare. Kjo është një kërkesë e cila nuk e pengon konkurrencën dhe është e bazuar në garancinë që ofertuesi i paraqet Autoritetit Konraktor.

2.2.2. Kopje te bilancit te miratuara nga Drejtoria Rajonale Tatimeve respektive te vitit 2020-2021-2022. Kjo kerkese konsiderohet e permbushur kur bilancet e dy viteve te njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.2.3. Nje vertetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mos shlyerja e detyrimeve te energjise elektrike,perben shkak per skualifikimin e operatorit ekonomik, pervec rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara te energjise elektrike, te konfirmuara ne vertetimin e leshuar nga furnizuesi jane ne process ankimi ne gjykate.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 40, pika 7 germa a.), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 pika 4 e VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” është përcaktuar që fuenizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme:

- ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit cilësisë”,
- ISO 14001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit ambjentit”

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO.

Çertifikatat duhet të jenë të vlefshme dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH.

Argumentimi: *Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licensat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.*

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021

Në bazë të nenit 79/1, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe neneve 40/5/a si dhe 44/1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit

Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që Autoriteti ose enti kontraktor të vërtetojë se furnizimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Bazuar në këto dispozita Autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon:

- a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara;
- b) efikasitetit të energjisë;
- c) sistemeve të menaxhimit mjedisor.

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë ne pronesi ose me kontrate qeraje te pakten 1(nje) automjet_5-10 ton te pershtatshem per transportin e lendes djegese.

Per te vertetuar kete OE ofertues duhet te paraqese si me poshte:

- Çertifikaten e pronësisë /ose kontrate qeraje noteriale.
- Leja e Qarkullimit.
- Polica e Sigurimit te detyrueshem te mjeteve motorrike.
- Kontrolli Teknik Vjetor – akt kolaudimin.
- Per automjetet e marra me kontrate noteriale qeraje OE duhet te kete kontraten e qerases te shoqeruar me aktin e pronesise ne emer te qiradhenesit, dokumentacionin e siperkerkuar dhe afati I marrjes me qera te mbuloje afatin e realizimit te procedures.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

2.3.4. Per realizimin e kontrates operatori ekonomik duhet te kete gjendje 3 (tre) copë kaldaja me pelet (me fuqi 480 – 500 KW) me keto te dhena:

o	Tipi	350/440
o	Fuqia min/max e punes	392 - 530 kw
o	Fuqia termike nominale	500 kw
o	Fuqia termike e kthyer	459 kw
o	tensioni i punes (elektrik)	380 v
o	Fuqia motorrike	1100 W
o	Rendimenti	87 %
o	Presioni i ujit	1,5 - 3,8 bar
o	Kapaciteti i ditor i silozit	1,5 m3

- ❖ Operatori ekonomik qe kualifikohet duhet te montoje paisjet djegese te peletit nga data e fillimit te kontrates deri ne perfundimin e saj ne ambientet e kaldajave te autoritetit kontraktor.
- ❖ Ofertuesi, me një deklaratë nga ana e tij të marrë përsipër montimin e kaldajave menjëherë mbas marrjes së njoftimit nga Autoriteti Kontraktor
- ❖ Paisjet teknike (kaldajat dhe djegësat/bruciatorët) duhet të jenë në pronësi të operatorit ekonomik ose në kontrata qeraje noteriale.
- ❖ Për të vërtetuar këtë, operatori ekonomik duhet të paraqesë akt çdoganimi ose kontratë shitblerje noteriale.
- ❖ Për paisjet teknike të marra me qera duhet të paraqitet kontratë qeraje noteriale e shoqëruar me dokumentin e pronësisë së qiradhënësit (akt çdoganimi ose kontratë shitblerje).
- ❖ Autoriteti kontraktor, ka të drejtën të kryejë verifikimin fizik të kaldajave dhe djegësave (bruciatorët), me lajmërim paraprak, përpara vlerësimit të ofertave nga KVO.
- ❖ Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë si dhe të përcaktojë saktë vendndodhjen e pajisjeve teknike, të cilat duhet të jenë brenda teritorit të Republikës së Shqipërisë.
- ❖ Ofertuesit duhet të paraqesin deklaratë nga administratori i shoqërisë që kaldajat e propozuar, nuk janë të angazhuara në ndonjë kontratë tjetër.

Ne rast bashkimi operatoresh ekonomik secili nga anetaret e BOE duhet te dorezoje dokumentacionin e kerkuar me siper sipas perqindjes se pjesemarrjes.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

SPECIFIKIMET TEKNIKE TE MALLIT "LENDE DJEGESE PER NGROHJE (PELET)":

Nr	TREGUESIT	NJESIA	PARAMETRAT
1	Densiteti	Kg/m ³	650
2	Fuqia kalorifike	Kw	4 - 4.2
3	Mbetja mbas djegjes (hirit)	%	0.1 - 0.2
4	Permbajtja e squfurit	%	0.0025 - 0.0030
5	Ambalazhimi	Thase	15 kg
6	Lageshtira	%	8.5 - 9.5
7	Dimensioni	mm	5 - 8

Te dhenat specifike te tre kaldajave per ngrohje (pelet) me keto te dhena:

- Tipi 350/440
- Fuqia min/max e punes 392 - 530 kw
- Fuqia termike nominale 500 kw
- Fuqia termike e kthyer 459 kw
- tensioni i punes (elektrik) 380 v
- Fuqia motorrike 1100 W
- Rendimenti 87 %
- Presioni i ujit 1,5 - 3,8 bar
- Kapaciteti i ditor i silozit 1,5 m³

Ne qoftese vertetohet qe malli nuk eshte sipas specifikimeve te permendura me lart atehere firma fituese do te skualifikohet.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/a dhe b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJESIA E PROKURIMIT